

Në kuadër të projektit “Partneriteti lokal kundër abuzimit të drogave dhe delikuencës së të miturve”

Program trajnues për edukatorët e rinj

Programi iu kushtohet të rinjve nga Ulqini – nxënës të shkollave të mesme, të cilët kanë shprehur dëshirën të bëhen “Edukatore bashkëmohatarë”. Trajnimi i edukatorëve bashkëmohatarë përbëhet nga tetë seminare njëditore, të cilët do të organizohen një herë në javë

Ulqin - Në Ulqin po organizohet programi për edukimin bashkëmohatar në fushën e parandalimit të narkomanisë dhe delikuencës së të miturve.

Programi iu kushtohet të rinjve nga Ulqini – nxënës të shkollave të mesme, të cilët kanë shprehur dëshirën të bëhen “Edukatore bashkëmohatarë”. Edukimi për bashkëmohatarë nënkupton të gjitha nismat ku të rinjtë e grupmoshave të njëjta informojnë dhe edukojnë njëri-tjetrin për çështje të ndryshme.

Në deklaratën për shtyp të Organizatës së Shoqërisë Civile “Horizonti i Ri” theksohet se trajnimi i edukatorëve bashkëmohatarë përbëhet nga tetë seminare njëditore, të cilët do të organizohen një herë në javë.

Programi, të cilin e menaxhojnë tra-

jnerë profesionistë, përfshin këto tema: zhvillimi i aftësive komunikuese, dëgjimi aktiv, sekretet e prezantimit të mirë – paraqitja publike, si të dallohen sëmundjet e varësisë – teknikat e rezistencës, marrja e qëndrimit dhe forcimi i vetëbesimit në luftën kundër sëmundjeve të varësisë, udhëheqja dhe rëndësia e zhvillimit të lidershit në komunitet, roli i edukatorit bashkëmohatar – aftësitë e organizimit të uorkshopeve, puna ekipore, zgjidhja e situatave të konfliktit etj.

Në këtë program marrin pjesë edhe përfaqësuesit e institucioneve relevante si dhe profesionistë të tjerë në këtë fushë.

Javën e kaluar, mysafire e programit ishte kryeprokurorja në Prokurorinë e Shtetit në Ulqin, Feriha Muratoviq, e

cila bashkëbisedoi me gjimnazistët për situatat kur të rinjtë bien në konflikt me ligjin.

Përveç sesioneve trajnuese, pjesëmarrësit e programit do të kenë mundësi të marrin pjesë edhe në aktivitete të tjera krijuese dhe publike.

Në fund të këtij programi, pjesëmarrësit e suksesshëm do të pajisen me diploma për “Edukatore bashkëmohatarë”.

Programi i edukimit bashkëmohatar është pjesë e projektit “Partneriteti lokal kundër abuzimit të drogave dhe delikuencës së të miturve”, të cilin e realizon Organizata e Shoqërisë Civile “Horizonti i Ri”, me mbështetjen e Ambasadës së SHBA-së në Podgoricë përmes Byrosë për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit. **(Kohapress)**

